

L I G J
Nr.7897, datë 2.2.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7786, DATË 27.1.1994 “PËR TATIMIN MBI TË
ARDHURAT PERSONALE”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7823, DATË 18.5.1994**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 2 të ligjit nr.7786, datë 27.1.1994, ndryshuar me ligjin nr.7823, datë 18.5.1994 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, pika 4 bëhet pika 3 dhe ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Të ardhurat nga qiratë e banesave, dyqaneve, magazinave, truallit dhe objekteve të tjera, si dhe të gjitha llojet e tjera të të ardhurave personale, cilido qoftë burimi i tyre”.

Neni 2

Në pikën 5 të nenit 3 pas fjalës “bankare” shtohen fjalët “si dhe nga interesat e bonove të thesarit e letrave të tjera me vlerë të Qeverisë”.

Në nenin 3, pas pikës 5, shtohen pikat 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“6. Të ardhurat e përfituara nga popullata nga kompensimet e ndryshme me letra me vlerë dhe të ardhurat nga ndarja pasurore si rezultat i privatizimit të ndërmarrjeve (24 paga mujore). Efektet e përjashtimit të ndarjes pasurore nga privatizimi i ndërmarrjeve shtrihen nga koha e krijimit të tyre.

7. Të ardhurat nga lojrat e fatit e kazinotë dhe të ardhurat nga konkurset e garat sportive”.

Neni 3

Neni 4 ndryshohet si vijon:

“Të ardhurat personale për pagat dhe shpërblimet për shërbime individuale deri në 7000 lekë në muaj përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale”.

Neni 4

Neni 5 ndryshohet si vijon:

“Tatimi mbi të ardhurat personale për pagat dhe shpërblimet për shërbime individuale caktohet si vijon:

1. Të ardhurat nga 7 001 deri në 12 000 lekë në muaj, shuma mbi 7 000 lekë në muaj tatohet 5 për qind.

2. Të ardhurat nga 12 001 deri në 30 000 lekë në muaj, tatohen 250 lekë plus 10 për qind të shumës mbi 12 000 lekë.

3. Të ardhurat nga 30 001 deri 50 000 lekë në muaj, tatohen 2050 lekë plus 15 për qind të shumës mbi 30 000 lekë.

4. Të ardhurat mbi 50 001 lekë në muaj, tatohen 5050 lekë plus 20 për qind të shumës mbi 50 000 lekë”.

Neni 5

Neni 6 ndryshohet si vijon:

“Tatimi mbi të ardhurat personale për veprat krijuese është 5 për qind dhe për llojet e tjera të të ardhurave personale, përveç të ardhurave personale të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, është 15 për qind”.

Neni 6

Neni 10 ndryshohet si vijon:

“Çdo individ që realizon të ardhura, cilido qoftë burimi i tyre, detyrohet të deklarojë të ardhurat sipas formës të përcaktuar nga Ministria e Financave”.

Neni 7

Dispozita kalimtare

“Parashkruhen të gjitha detyrimet e rrjedhura nga tatimi mbi të ardhurat nga konkurset dhe llotaritë para datës 18.5.1994”.

Neni 8

Ligji nr.7823, datë 18.5.1994 “Për një ndryshim në ligjin nr.7786, datë 27.1.1994 “Për tatimin mbi të ardhurat personale” shfuqizohet.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi më 1.3.1995.

Shpallur me dekretin nr.1019, datë 14.2.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha